

Член 9

Одредбите од членовите 1, 2, 3, 5 и 6 од овој закон, ќе започнат да се применува со започнувањето на примената на Законот за општата управна постапка согласно со членот 141 од Законот за општата управна постапка („Службен весник на Република Македонија“ број 124/15).

Член 10

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
PËR MBROJTJE TË FËMIJËVE**

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15 dhe 192/15), në nenin 41 pas paragrafit (6) shtohen dy paragrafë të rinj (7) dhe (8) si vijojnë:

"(7) Personi i autorizuar zyrtar nga qendra për punë sociale i cili e udhëheq procedurën nga paragrafi (6) i këtij neni është i detyruar që në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për realizimin e të drejtës për mbrojtje të fëmijëve, me detyrë zyrtare të kërkojë dokumentacion për të cilën subjekti nga paragrafi (5) i këtij neni mban evidencë zyrtare.

(8) Personi i autorizuar zyrtar nga paragrafi (5) i këtij neni nga i cili është kërkuar dokumentacion nga paragrafi (7) i këtij neni është i detyruar që ta dorëzojë dokumentacionin e kërkuar në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës."

Paragrafi (7) bëhet paragraf (9).

Në paragrafin (8) i cili bëhet paragraf (10) fjalët: "paragrafi (2)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (3)".

Neni 2

Në nenin 42 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Me kërkesë për realizimin, përkatësisht vazhdimin e të drejtës për mbrojtjen e fëmijëve nga neni 6 i këtij ligji, përveç për të drejtën nga pika 5, vendos qendra për punë sociale kompetente për rajonin në të cilin parashtruesi i kërkesës ka vendbanim në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, për ndihmë të njëhershme monetare për foshnjë të porsalindur vendos qendra kompetente për rajonin në të cilin e ëma ka vendbanim të përhershëm në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës dhe për shtesë prindërore për fëmijë vendos qendra kompetente për rajonin në të cilin e ëma ka vendbanim të përhershëm në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës."

Në paragrafin (2) fjala "ministri" zëvendësohet me fjalën "ministra".

Neni 3

Neni 46 shlyhet.

Neni 4

Në nenin 120 në paragrafët (2) dhe (3) fjalët: "ose APTIS - së paku niveli A2" shlyhen.

Neni 5

Pas nenit 195 shtohet nen i ri 195-a si vijon:

"Neni 195-a

(1) Evidenca për shfrytëzuesin e të drejtave në para nga mbrojtja e fëmijëve përmбан të dhëna për të drejtën e realizuar të:

- shtesës fëmijërore,
- shtesës së veçantë,
- ndihmës së njëhershme monetare për foshnjë të porsalindur dhe
- shtesës prindërore për fëmijë.

(2) Evidenca si dhe baza e të dhënave për shfrytëzuesit e të drejtave për mbrojtje të fëmijëve nga paragrafi (1) i këtij neni, përmбан të dhëna për numrin unik амë, gjininë, moshën, adresën e banimit dhe të dhëna tjera për shfrytëzuesin dhe anëtarët e familjes së tij, të cilat kanë të bëjnë përcaktimin sidomos të statusit personal, material, shëndetësor dhe social.

(3) Evidenca si dhe baza e të dhënave të shfrytëzuesve të shërbimeve në institucionet e fëmijëve përmбан të dhënat për fëmijët e përfshirë në institucionet për fëmijë (NUAQ, mbiemrin, emrin e babait dhe emrin e fëmijës, datën dhe vendin e lindjes, përkatësinë e komunitetit, adresën, vendin e jetesës, të dhëna për statusin shëndetësor të fëmijës); prindërit ose kujdestarët e fëmijëve shfrytëzues të shërbimeve në institucionet për fëmijë (lidhja farefisnore me fëmijën, emri dhe mbiemri, NUAQ, data dhe vendi i lindjes, gjinia, përkatësia e komunitetit, adresa dhe vendi i banimit, telefoni i kontaktit, adresa meil, shkalla e arsimit), si dhe për të punësuarit në institucionet për fëmijë (NUAQ, mbiemrin, emrin e babait dhe emrin e të punësuarit, gjininë, përkatësinë e komunitetit, datën dhe vendin e lindjes, adresën dhe vendin e qëndrimit, komunën, shtetësinë, llojin dhe nivelin e arsimit, shkollën / fakultetin e fundit të kryer, përvoja e mëparshme të punës, kategorinë e të punësuarit, vendin e punës, telefonin e kontaktit, adresën meil, datën e punësimit, datën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, invaliditetin, njësinë rajonale të FSSH, numrin SPIM, bazën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, statusin e të punësuarit).

(4) Evidenca si dhe baza e të dhënave në paragrafin (3) të këtij neni, mbahen me qëllim të avancimit të proceseve dhe procedurave të nevojshme për menaxhim me burimet njerëzore, financat dhe infrastrukturën në institucione për fëmijë, sigurim të të dhënave të sakta në kohë, konzistente, dhe të plota që do të paraqesin përkrahje të procesit të miratimit të vendimeve, zbatim të politikave dhe planifikim të reformave në veprimtari, sigurim të të dhënave për mbajtje elektronike të evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit.

(5) Në grumbullimin, përpunimin, shfrytëzimin, shkëmbimin dhe ruajtjen e të dhënave për shfrytëzuesit nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni zbatohen dispozitat nga ligji me të cilin rregullohet mbrojtja e të dhënave personale."

Neni 6

Në nenin 226 pas paragrafit (4) shtohen dy paragrafë të rinj (5) dhe (6), si vijojnë:

(5) Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlere me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga qendra për punë sociale e cila e udhëheq procedurën, nëse:

- nuk i merr siguron në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 41 paragrafi (7));

- nuk vendos për kërkesën në afat prej 60 ditësh përkatësisht në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 42 paragrafi 1)) dhe

